

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Hybrid Energy” SHPK**

Me date 19.01. 2023, themeluesi i meposhtemi:

**Agim Bedo**, i biri i Jorgo, lindur me date 18.04.1964 ne Gjirokastrer dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga leternjofirmi me Nr. Personal G40418075R.

Ka vendosur krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe nenshkruan Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga percaktimet ne kete akt themelimi dhe nga statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

**KREUI I**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqeria “ **Hybrid Energy** “ **SHPK**, eshte person juridik i se drejtes shqiptare. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me poshte e quajtur “Shoqeria”.

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqeria e ka seline ne: Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres, km 11, Godina “Hybrid”.

**Neni 4**

**Kohezgjatia**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 5**

**Objekti i veprimtarise**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise:

Tregti, ndertim, import-eksport me shumice dhe pakice e pajisjeve fotovoltaike, impiante teknologjike, termike, te kondicionimit etj.

Shoqeria mund te bashkepusoje edhe me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj.

Shoqeria ka te drejte te shtojte objektin e veprimtarise se saj, ne cdo kohe sipas ligjeve ne fuqi.

**KREUI II**

**KAPITALLI**

**Neni 6**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100,000 (Njehind mije) leke**, i perbere nga nje kuote e vetme me vlere te pergjithshme **100,000 (Njehind mije) leke**, e cila perben **100%** te kapitalit themeltar te shoqerise.

*Ortaku themelues i Shoqerise "Hybrid Energy" SHPK, Z. Agim Bedo eshte zoteruesi i 1 (nje) kuote me vlere 100,000 (Njehind mije) leke, e cila perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.*

Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardheseve dhe pasardheseve. nepermjet akteve ligjore.

## KREU III

### ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

#### Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marjen e vendimeve per shoqerine per geshjtjet e meposhtme:
  - percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
  - ndryshimet e statutit;
  - emerimin e shkarkimin e administratorit/ve;
  - emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "g" te kesaj pike;
  - mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - perfagesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
  - miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
  - geshjte te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per geshjtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "g" te pikes 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
3. Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fsihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - investime;
  - vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
4. Ortaku i vetem mund te perfagesohet edhe nga nje tjeter person, nepermjet prokures.

5. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thihret te pakten nje here ne vit.

#### Neni 9

##### Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shogerise.

#### Neni 10

##### Administrimi

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem te shogerise.

Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake te shogerise.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo kohe.

Administratori i shogerise eshte Z. **Agim Bedo**, njekohesisht dhe ortaku i vetem i saj.

Administratori i shogerise do te ushtrroje kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe **pese vjecare**, sipas ligjit.

#### Neni 11

##### Kompetencat e Administratorit

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shogerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- Kujdeset per mbajtjen e sakre e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shogerise;
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraget keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kerencojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shogerise;
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shogerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- Raportojte perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaqme me rendesi te vecante per veprimtarine e shogerise tregtare;
- Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem;
- Administratori perfageson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve;
- Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shogerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shogerise;
- Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj;
- Administratori ka gjithashtu te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshire ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerive te

- tjera ku Shogeria eshte ortak;
- te nenshkruaje e hartoje çdo dokument e te kryeje ne emer te Shogerise çdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me gelsen apo mbylljen e llogarive rjedhese te Shogerise, nenshkrimi i kontratave te ndryshme bankare per financimin e Shogerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdijje shumash nga keto llogari pa limit;
- Shogeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shogerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke pasur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme;
- Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet;
- Administratori ose ortaku qe nuk eshte person juridik, nuk u lejohet te kontraktrojne ne çfarëdolloj forme qofte, te marin hua te shogeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per parardhenie si dhe te behen dorezues apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme;

#### Neni 12

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shogerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.  
 Perjashmish viti i pare- financiar fillon nga data e regjistrimit te shogerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 13

##### Shperndarja ose prishja e shogerise

Shperndarja ose prishja e shogerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimi te metejshem te veprimtarise se saj;
  - b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shogerive Tregtare"
  - c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtimin e veprimtarise tregtare.
- Ne kete rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shogerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emerresen shrese " Shogeri ne likuidim e siper " .

#### Neni 14

##### Baza Ligjore

Shogeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shogerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se shogerise.

#### Neni 15

##### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u hartua ne 4 ekzemplare me permblajtje dhe vlera te njejta juridike, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shogerise tregtare "Hybrid Energy" SHPK,

**ORTAKU THEMELUES**

Z. AGIM BEDO

